

L I G J
Nr.9458, datë 21.12.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 "PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimim mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Tabela nr.1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Neni 12 "Fitimet nga lojërat e fatit dhe kazinotë" shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 13 pikat 3 e 4 shfuqizohen.

Neni 4

Në fund të nenit 18 "Përgjashtimet" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Të gjitha subjektet e përmendura në shkronjën "a" deri në shkronjën "ë" të këtij neni, pavarësisht nga përjashtimi nga pagimi i tatimit mbi fitimin, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin kontabël vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin."

Neni 5

Në nenin 22 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind."

Neni 6

Neni 23 "Inventari" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23
Inventari

Inventari, në fund të periudhës tatimore, vlerësohet sipas njërës nga metodat e përcaktuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe duhet të zbatohet në mënyrë sistematike."

Neni 7

Neni 28 "Shkalla tatimore" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 28
Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 20 për qind."

Neni 8

Në nenin 33 pika 4 shfuqizohet.

Neni 9

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 33/1
Destinimi i fitimit

1. Shoqëritë tregtare, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, në përputhje edhe me dispozitat e nenit 56 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë, në Asamblenë e Ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë, rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahej në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik, vendimin e organit përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij neni. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekësh, për çdo muaj apo pjesë të muajit.

3. Personi juridik duhet të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se data 30 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividendit."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

TABELA NR.1
TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në muaj)	TAP		Përqindje
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	Lekë	
0	14 000	0	+1 % të shumës mbi 0 lekë
14 000	40 000	140	+ 5% të shumës mbi 14 000 lekë
40 000	90 000	1 440	+ 10% të shumës mbi 40 000 lekë
90 000	200 000	6 440	+ 15% të shumës mbi 90 000 lekë
200 000	Më tepër	22 940	+ 20% të shumës mbi 200 000 lekë

